



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
KOMISIONI DISIPLINOR

V E N D I M

Nr. 1, datë 15.11.2021

Komisioni Disiplinor i Përmbarduesve Gjyqësorë Privatë, i konstituuar më datë **10.2.2021** dhe përbërë nga:

Vangjel Kosta	Kryetar
Tedi Malaveci	Anëtar
Erind Mërkuri	Anëtar

mori në shqyrtim kërkesën me nr. prot. {...}, datë {...} të Ministrisë së Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj përmbarduesit gjyqësor privat {...} {...}.

Kërkesa bazohet në gjetje dhe vlerësime ndaj veprimtarisë së përmbarduesit {...} {...}, që në raportin bashkëlidhur kërkesës dhe dokumentacionit pjesë përbërëse të tij, evidentoheshin se përbënin shkelje disiplinore. Raporti evidentohet se është përpiluar pas hetimit disiplinor kryer nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, që ishte iniciuar për shkak të ankesave të paraqitura nga ana e shtetases {...} {...} dhe shoqëria {...} ({...}).

Ministri i Drejtësisë, Etilda Gjonaj (Saliu) me urdhrin nr. {...}, datë {...}, krijoi një grup kontrolli për kryerjen e hetimit administrativ dhe verifikimin e dosjeve përmbardimore, për të cilat ishin depozituar ankesat. Grupi i Kontrollit, në datën {...}, përfundoi punën e tij me dorëzimin e dokumentit datë {...} “*Raport për kryerjen e hetimit administrativ pranë përmbarduesit gjyqësor privat {...} {...}*”.

Referuar kërkesës dhe gjetjeve të pasqyruara në raport, motivacioni ligjor mbi të cilin bazohet kërkesa për nisjen e procedimit disiplinor, referon në përcaktimet e pikës 1 të nenit 71 të ligjit nr. 26/2019 “*Për shërbimin përmbardimor gjyqësor privat*”.

Komisioni Disiplinor e zhvilloi veprimtarinë e tij bazuar në ligjin nr. 26/2019 “*Për shërbimin përmbardimor gjyqësor privat*” dhe urdhrin nr. 189, datë 22.6.2020 të ministrit të Drejtësisë “*Për miratimin e rregullores për konstituimin, organizimin, funksionimin dhe shpërblimin e anëtarëve të komisionit disiplinor të përmbarduesve gjyqësorë privatë*”, duke respektuar plotësisht të drejtat e përmbarduesit {...} {...} dhe zbatuar me rigorozitet parimet e hetimit administrativ, me qëllim vlerësimin e kërkesës dërguar për shqyrtim para Komisionit Disiplinor, nga ministri i Drejtësisë.

Kërkesa me nr. prot. {...}, datë {...}, për fillimin e procedimit disiplinor dhe vetë raporti që shoqëronte kërkesën, i është njoftuar paraprakisht përmbaruesit {...} {...} në datën {...}, me shkresën nr. {...} prot., “Njoftim për paraqitje në seancë dëgjimore”, sikundër dhe nëpërmjet njoftimit elektronik në adresën elektronike zyrtare të vetëdeklaruar pranë Ministrisë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.

I. Konflikti i interesit.

1. Të tre anëtarët e këtij Komisioni, në fillim të procesit deklaruan se nuk ishin para ndonjë pengese ligjore në shqyrtimin e këtij procedimi disiplinor; nuk ndodheshin në kushtet e konfliktit të interesit dhe/ose nuk kishin asnjë pengesë ligjore në shqyrtimin e plotë, në mënyrë të paanshme dhe objektive të këtij procedimi disiplinor.

II. Baza ligjore e vendimmarrjes.

1. Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë (Parimet e përgjithshme dhe hetimi administrativ);
2. Ligji nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”;
3. Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë;
4. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;
5. Udhëzimi i përbashkët nr. 385/7, datë 28.6.2017 i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor privat”;
6. Urdhri nr. 3851, datë 8.5.2009 i ministrit të Drejtësisë (në fuqi në kohën kur pretendohet se janë kryer veprimet e konsideruara si shkelje) dhe urdhri nr. 136, datë 27.4.2020 i ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e Kodit të Etikës së Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë”;
7. Urdhri nr. 189, datë 22.6.2020 i ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores për konstituimin, organizimin, funksionimin dhe shpërblimin e anëtarëve të komisionit disiplinor të përmbaruesve gjyqësorë privatë”.

III. Mbledhjet e komisionit disiplinor, qëndrime dhe komunikime në procesin disiplinor.

1. Komisioni Disiplinor, në datë 10.6.2021, zhvilloi mbledhjen e parë si seancë dëgjimore me përmbaruesin {...} {...}.
2. Mbledhjen e drejtoi kryetari i Komisionit Disiplinor z. Vangjel Kosta, i cili e ftoi përmbaruesin {...} {...} të shprehej në lidhje me anëtarët e Komisionit. Përmbaruesi deklaroi se nuk kishte asnjë kundërshtim me përbërjen e Komisionit Disiplinor.
3. Përmbaruesi {...} {...} deklaroi se ishte njohur me të gjithë elementët e raportit të përpiluar nga punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë dhe shprehu qëndrimin se: “Nuk pranoj të kem kryer asnjë shkelje ligjore të natyrës disiplinore apo etike përgjatë punës sime si përmbarues gjyqësor deri ditën që kam pezulluar aktivitetin për shkak të një funksioni në një zyrë dhe funksion shtetëror, si dhe jam kundër shkaqeve që janë konsideruar nga ministrja e Drejtësisë për të filluar hetimin disiplinor”.

4. Gjatë seancës dëgjimore, ishte i pranishëm përfaqësuesja i Ministrisë së Drejtësisë, znj. {....} {....}, e cila depozitoi përpara Komisionit urdhrin nr. {....}, datë {....}, të ministrit të Drejtësisë “Për përfaqësimin në seancën dëgjimore pranë Komisionit Disiplinor”.
 - 4.1 Përmbauesi {....} {....} kërkoi nga Komisioni Disiplinor që të verifikojë paraprakisht statusin dhe pozitën e përfaqësuesit të Ministrisë së Drejtësisë në raport me parashikimet ligjore në fuqi, që lidheshin me rekrutimin dhe njohuritë specifike mbi shërbimin dhe procedurat përmbaimore.
 - 4.2 Komisioni Disiplinor ndërpreu seancën dëgjimore dhe mori në shqyrtim kërkesën e përmbauesit {....} {....} lidhur me pretendimet e tij ndaj përfaqësuesit të ministrit të Drejtësisë. Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni Disiplinor, me shumicë votash (2 “pro” me 1 “kundër”) vendosi të lejojë përfaqësuesin e Ministrisë së Drejtësisë (znj. {....} {....}) të marrë pjesë në seancën dëgjimore, duke e kufizuar atë, në të drejtën për të dhënë sqarime përpara Komisionit, vetëm për çështjet që do të ngriheshin apo do konsideroheshin të nevojshme për t’u pyetur gjatë seancës dëgjimore prej anëtarëve të Komisionit.
5. Përmbauesi {....} {....} parashtroi kërkesa të tjera ndaj përfaqësuesit të Ministrisë së Drejtësisë lidhur me përmbajtjen e raportit të përpiluar, motivacionit ligjor mbi të cilin bazohej kërkesa për nisjen e procedimit disiplinor dhe ekspertët (inspektorët) që kishin përpiluar raportin.
6. Anëtarët e Komisionit Disiplinor, pasi dëgjuan përfaqësuesin e Ministrisë së Drejtësisë, që kërkoi kohë për t’u përgatitur mbi pyetjet përkatëse, vendosën t’i japin kohë këtij të fundit, për të paraqitur shpjegimet e nevojshme rreth pyetjeve të përmbauesit dhe dokumentacionin zyrtar të kërkuar prej tij. Komisioni, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të ndërpresë seancën dëgjimore duke caktuar vijimin e saj në datën 24.6.2021.
7. Seanca e dytë dëgjimore me përmbauesin {....} {....} u zhvillua më 24.6.2021.
8. Në seancë u paraqit veç përmbauesit edhe përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë, znj. {....} {....}, e cila depozitoi para komisionit një set dokumentesh dhe parashtroi shpjegimet rreth tij, lidhur me pyetjet dhe kërkesat e bëra nga përmbauesi {....} {....}, në seancën e datës 10.6.2021.
9. Përmbauesi {....} {....} depozitoi para Komisionit parashtrime me shkrim në lidhje me procedimin disiplinor pasi i shpjegoi ato edhe në formë të përmbledhur verbale.
10. Përmbauesi {....} {....} dërgoi tre *e-mail-e* në adresë të Komisionit Disiplinor, në datat:
 - a) {....} – Parashtrime në lidhje me procedimin disiplinor ndaj përmbauesit {....} {....};
 - b) {....} – Në vijim të seancës së djeshme;
 - c) {....} – Kërkesë.

IV. Në lidhje me pretendimet e palëve.

1. Ministria e Drejtësisë përfundimisht, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, znj. {...} {...}, kërkoi marrjen e masës disiplinore treguar në raportin dhe kërkesën përkatëse ndaj përmbaruesit gjyqësor privat, {...} {...}.

2. Përmbaruesi {...} {...} në konkluzionet e tij shpjegoi se,

- a) Grupi i Kontrollit mori gjithë dokumentacionin e dosjeve përmbarimore që duhet të inspektoheshin, por asnjëherë nuk e pyeti rreth ndonjë akti, madje nuk mori asnjëherë përgjigje rreth shkresës nr. {...}, datë {...}.
- b) Nuk ka asnjë provë që të provojë se, përmbaruesi ka shkelur ligjin dhe aktet nënligjore. Janë respektuar urdhërimet e Kodit të Etikës dhe është lejuar kryerja e kontrollit nga grupi i kontrollit të Ministrisë së Drejtësisë. Për sa i përket respektimit të konfidencialitetit të të dhënave, ky pretendim nuk u argumentua fare, ndërsa për sa i përket respektimit të konfidencialitetit theksoi se, ministri i Drejtësisë të njëjtën shkresë e ka dërguar në adresë të të gjithë ankuesve.
- c) Ministri i Drejtësisë nuk ka zbatuar udhëzimin e tij nr. 13, datë 17.7.2020, për sa i përket përbërjes së grupit të kontrollit, pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të Komisionit Disiplinor, përbërja e anëtarëve nuk i përket drejtorisë/strukturës përgjegjëse të Ministrisë së Drejtësisë, por zyrave përmbarimore konkurrenente.
- d) Ministri i Drejtësisë ka shkelur procedurën e parashikuar në ligjin nr. 26/2019, datë 8.5.2019, për sa i përket hetimit/procedimit disiplinor, pasi hetimi ka zgjatur 6 muaj.
- e) Ministri i Drejtësisë është informuar nga ana e përmbaruesit {...} {...} në lidhje me ankesën që prej vitit 2019, ndërkohë që bazuar në procesverbalin/provën më të fundit, shkeljet janë konstatuar në muajin shtator 2020.
- f) Ministri i Drejtësisë nuk ka respektuar nenet 58, 62 (paragrafi 4), 66, 67, 70 të ligjit nr. 26/2019, datë 8.5.2019.
- g) Ministria e Drejtësisë nuk ka gjetur asnjë shkelje, nga ato të sanksionuara në nenin 84 të ligjit 26/2019, duke bërë me dije se, nuk ka qenë asnjëherë subjekt i procedimeve disiplinore, madje nuk është marrë asnjë vërejtje ndaj tij.
- h) Ministria e Drejtësisë ka shkelur në të gjitha rastet, përveç dosjes përmbarimore me subjekt {...}, nenet 71 (paragrafi c) dhe 85 (paragrafi 2) të ligjit nr. 26/2019 “*Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat*”.
- i) Urdhri nr. {...}, datë {...}, i ministrit të Drejtësisë, për nisjen e procedimit disiplinor për përmbaruesin gjyqësor privat {...} {...} është marrë në kundërshtim me ligjin organik. Megjithatë, edhe sikur të vërtetohej ndonjë shkelje, atëherë Komisioni Disiplinor duhej që të merrte vendimin për konstatimin e shkeljes, brenda periudhës {...}, periudhë gjatë së cilës grupi i kontrollit nuk kishte përfunduar raportin.

2.1 Përfundimisht, përmbaruesi {...} {...} kërkoi nga Komisioni Disiplinor, rrëzimin e kërkesës së ministrit të Drejtësisë, bazuar në shkronjën “a”, pika 2 e nenit 80 të ligjit nr. 26/2019 “*Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat*”.

V. Në lidhje me gjetjet, konstatimet dhe shkeljet e konstatuara në raportin e Ministrisë së Drejtësisë.

Nga materiali dokumentar paraqitur nga ministri i Drejtësisë, janë ngritur disa pretendime mbi veprimtarinë e përmbaruesit {....} {....}, që lidhen me veprime të ndryshme përmbarimore të kryera prej tij, të shtrira në kohë. Konkretisht, janë referuar si shkelje, aktet e mëposhtme përmbarimore:

- i. Shkresa nr. {....} prot., datë {....} drejtuar kreditores {....} {....}, për zgjidhjen e kontratës së shërbimit, në të cilën është shprehur “{....}”;
- ii. Urdhër nr. {....} prot., datë {....} drejtuar {....}, me qëllim shlyerjen e detyrimeve monetare dërguar gjatë kohës së shpalljes së pandemisë;
- iii. Shkresa nr. {....} prot., datë {....} drejtuar {....}, me anë të së cilës ka kërkuar kryerjen e hetimit administrativ për personat përgjegjës, që nuk kanë lejuar transaksionet dhe janë bërë pengesë për ekzekutimin e vendimit të gjykatës;
- iv. Urdhër nr. {....} prot., datë {....}, drejtuar debitorit për anulimin e urdhrin nr. {....} prot., datë {....} (*heqjen e sekuestros apo lënien të lirë të llogarisë*);
- v. Kontrata e shërbimit e hartuar nga përmbaruesi {....} {....} si person fizik, për të cilën nuk është njoftuar kreditori kur është ndryshuar mënyra e ushtrimit të funksionit si person juridik, pas regjistrimit në QKB të shoqërisë “{....}”, me ortak të vetëm përmbaruesin {....} {....};
- vi. Shkresat nr. {....} prot., datë {....}, nr. {....} prot., datë {....}, të nxjerra në kundërshtim me vullnetin e debitorit;
- vii. Shkresa nr. {....}, datë {....} drejtuar Degës së Thesarit për dosjen e kreditores {....} {....}, e cila është në kundërshtim me aktin normativ nr. 13, datë 2.4.2020;
- viii. Debitorit {....} nuk i janë njoftuar aktet përmbarimore vendim nr. {....} prot., datë {....}, urdhër nr. {....} prot., datë {....} dhe vendim nr. {....} prot., datë {....};
- ix. Veprimi përmbarimor vendim nr. {....} prot., datë {....} “*Për pushimin e ekzekutimit*”, pa u përbushur plotësisht detyrimi është konstatuar si shkelje në raport, por nuk mund të jepet masë disiplinore, pasi kanë kaluar më shumë se dy vjet nga çasti i kryerjes së saj;
- x. Vendimi nr. {....} prot., datë {....} “*Për caktim ekspert*” nuk i mundëson debitorit shoqëria “{....}” sh.p.k. ankimin ndaj veprimit përmbarimor për shkaqe ligjore;
- xi. Fatura tatimore e shitjes nr. {....}, datë {....} nuk përputhet me vlerën e plotë të detyrimit, prandaj është konsideruar si faturë e paplotë përmbarimore;
- xii. Vendim nr. {....} prot., datë {....} për rastin e debitores {....} {....};
- xiii. Me vendimin nr. {....} prot., datë {....}, përmbaruesi ka kryer disa veprime përmbarimore, për të cilat parashikohet e drejta e ankimit për secilin prej tyre;
- xiv. Shkresa nr. {....} prot., datë {....} drejtuar debitores {....} {....} është konsideruar jo profesionale. (Dosja e {....} {....} është në prokurori dhe për këtë praktikë është rekomanduar pezullimin i hetimit, deri në dhënien e vendimit formë të prerë).
- xv. Në praktikën me kreditor {....} {....}, grupi i kontrollit nuk ka gjetur asnjë faturë që të provojë parapagimin e tarifës përmbarimore.

1. Komisioni Disiplinor, më së pari vlerësoi nëse në referimin e rasteve, ministri i Drejtësisë kishte respektuar parashikimin e nenit 85, pika 2 të ligjit nr. 26/2019, që përcakton se:

“2. Masat disiplinore jepen brenda 6 muajve nga data e konstatimit të shkeljes, por jo më vonë se 2 vjet nga çasti i kryerjes së saj. Në këtë rast parashkrimi i masës fillon pas afateve të përcaktuara”.

1.1 Nga përmbajtja e normës së mësipërme rezulton se, ka dy afate brenda të cilëve, organi procedues, Ministria e Drejtësisë, duhet që të veprojë dhe konkretisht afati “dy vjeçar” dhe afati “gjashtë mujor”. Afat 2-vjeçar është një afat i përgjithshëm, i cili pengon ministrin e Drejtësisë që të fillojë një procedim disiplinor, nëse nga momenti i shkeljes deri në konstatimin e saj, kanë kaluar të paktën 2 vjet. Në këtë rast, procedimi administrativ nuk mund të fillojë. Për të përcaktuar momentin e fillimit dhe të mbarimit të këtij afati rezulton se Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 56, pikat 2 dhe 3 të tij parashikon se:

“2. Kur afati caktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati.

3. Afati i përcaktuar në muaj ose vite mbaron me kalimin e asaj dite, atij muaji apo atij viti të fundit, që ka të njëjtin numër me atë të ditës, në të cilën ka ndodhur ngjarja nga e cila ka filluar të ecë afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji”.

1.2 Bazuar në parashikimin e mësipërm, afati 2-vjeçar rezulton se fillon nga e nesërmja e shkeljes së konsumuar nga përmbartuesi privat dhe përfundon në të njëjtën ditë, të të njëjtit muaj, të vitit të dytë.

1.3 Qëllimi i këtij parashikimi ligjor është i dyfishtë, ku së pari synohet që subjektet e përfshirë në një procedurë ekzekutimi të detyrueshëm të jenë aktiv në mbrojtjen e të drejtave të tyre, si edhe organi procedues, Ministria e Drejtësisë, të jetë aktive në realizimin e rolit të saj mbikëqyrës dhe kontrollues. Arsyeja e dytë lidhet me parimin e sigurisë juridike, ku subjektet e ndryshme të së drejtës nuk mundet që të shqetësohen për situata apo ngjarje të ndodhura në të shkuarën dhe për të cilat ka kaluar një kohë e gjatë. Kjo kohë nga ana e ligjvënësit është çmuar të jetë 2 vjet.

1.4 Bazuar në analizën e mësipërme, Komisioni do të vlerësojë nëse shkeljet e pretenduara nga ana e Ministrit të Drejtësisë në këtë procedim disiplinor, janë parashkruar apo jo.

1.5 Për sa i përket pretendimit se nuk është parapaguar tarifa përmbartimore nga ana e kreditorit (znj. {....} {....}), Komisioni çmon se kontrata e lidhur midis përmbartuesit dhe kreditorit është e datës {....}. Për rrjedhojë, në këtë ditë duhej që të kryhej edhe lëshimi i faturës tatimore përkatëse dhe parapagimi i detyrimit.

1.6 Po kështu, rezulton se hetimi disiplinor ka nisur me Urdhrin nr. {....}, datë {....} të ministrit të Drejtësisë.

1.7 Duke krahasuar këto data, rezulton qartazi se jemi para parashkrimit të pretendimit për këtë shkelje dhe për rrjedhojë, nuk mundet që të merret në shqyrtim nga ana e Komisionit Disiplinor pretendim që lidhet me parapagimin e tarifës përmbartimore.

2. Mbi pretendimin për kryerjen e veprimeve përmbartimore gjatë ndalimit të tyre për shkak të pandemisë COVID-19.

2.1 Në Shqipëri, në muajin mars 2020, me urdhrin nr.156/2, datë 11.3.2020, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për shpalljen e pandemisë nga infeksioni COVID-19”, u shpall gjendja e jashtëzakonshme e pandemisë shkaktuar nga sëmundja infektive Covid-19.

2.2 Me vendimin nr. 243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, u shpall gjendja e fatkeqësisë natyrore. Në kuadër të masave të marra, nga Këshilli i Ministrave u miratua akti normativ me fuqinë e ligjit nr.13, datë 2.4.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë së shërbimit përmbartimor gjyqësor, ndërmjetësimit dhe administrimit të procedurave të falimentimit gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”. Ky akt normativ është miratuar nga Kuvendi me ligjin nr. 34/2020, datë 16.04.2020. Sipas neni 3 të tij rezultonte se:

“1. Nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19 pezullohen afatet për kryerjen e veprimeve procedurale të përmbartuesit gjyqësor shtetëror apo privat, ndërmjetësit dhe administratorit në procedurat e falimentimit. Kur afatet për kryerjen e veprimeve procedurale sipas parashikimit të legjislacionit në fuqi fillojnë gjatë periudhës së pezullimit, ato shtyhen deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë.

2. Rregullat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nuk zbatohen në këto raste:

a) Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë që rrjedhin nga çështje familjare, me objekt kujdesin, detyrimet dhe respektimin e të drejtave të të miturve, kujdestarinë, birësimin, ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, përkujdesjen dhe detyrimet për ushqim;

b) Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, me objekt urdhrat e mbrojtjes dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes;

c) Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, me objekt masat e sigurimit të padisë për çështje administrative dhe për çështjet civile, në të cilat gjykata ka dhënë vendim për sigurimin e padisë ose vendim me ekzekutim të përkohshëm, kur nga vonesa e ekzekutimit ose e kryerjes së veprimeve procedurale bëhet i pamundur ekzekutimi i këtyre titujve ekzekutivë, pas përfundimit të gjendjes së epidemisë;

ç) Nëse është e domosdoshme shmangia e dëmtimit të masës së falimentimit;

d) Për ndërmjetësimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën penale, kur gjatë hetimit vlerësohet si e nevojshme për mbrojtjen e interesave të të miturit.

3. Gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19, në funksion të zbatimit të rregullave nënligjore të nxjerra nga organet përgjegjëse shtetërore, organet e shërbimit përmbartimor shtetëror dhe privat, të ndërmjetësve dhe administratorëve të falimentimit, në të gjitha rastet, marrin masa organizative të posaçme për të shmangur grumbullimet, kontaktet e ngushta ndërmjet individëve, si dhe praninë e publikut në ambientet e ushtrimit të aktivitetit të përmbartuesit gjyqësor, ndërmjetësit dhe administratorit të falimentimit”.

2.3 Nga sa më sipër rezulton se një nga masat e marra për frenimin e sëmundjes infektive Covid-19 ishte edhe ndalimi i veprimeve përmbartimore, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga pika 2 e kësaj dispozite. Në rastin konkret, rezulton se përmbartuesi privat {....} {....}, i atribuohet kryerja e këtyre veprimeve procedurale gjatë këtij harku kohor:

1) Shkresa nr. {....} prot., datë {....};

2) Shkresa nr. {....} prot., datë {....};

3) Shkresa nr. {....} prot., datë {....}.

2.4 Komisioni konstaton gjithashtu se akti normativ me fuqinë e ligjit nr.13, datë 2.4.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë së shërbimit përmbartimor gjyqësor, ndërmjetësimit dhe administrimit të procedurave të falimentimit gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së

epidemisë së shkaktuar nga COVID-19” është shfuqizuar me aktin normativ me fuqinë e ligjit nr. 22, datë 27.5.2020. Ky akt është miratuar nga Kuvendi me ligjin nr. 76/2020, datë 25.6.2020.

2.5 Pavarësisht kohës së botimit të akteve normative me fuqinë e ligjit në “Fletoren Zyrtare” apo të miratimit të tyre nga Kuvendi, Gjykata Kushtetuese në lidhje me kohën e hyrjes në fuqi të këtyre akteve, me vendimin nr. 24, datë 10.11.2006, ka mbajtur qëndrimin se:

“Hyrja në fuqi e aktit normativ me fuqinë e ligjit dallon nga hyrja në fuqi e ligjit, të cilën Gjykata Kushtetuese e ka interpretuar qartë, me vendimin e saj nr. 47, datë 7.7.1999. Për të interpretuar këtë aspekt të aktit normativ me fuqinë e ligjit, Gjykata Kushtetuese çmon se duhen mbajtur parasysh përmbajtja dhe specifikat e nenit 101 të Kushtetutës. Elemente të tilla, si nevoja dhe urgjenca, tregojnë se aktet në fjalë duhet të hyjnë në fuqi menjëherë. Këto elemente, që qëndrojnë në bazë të transferimit kushtetues të së drejtës së nxjerrjes së aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi drejt Këshillit të Ministrave, do të zhvleftësoheshin nëse, për hyrjen në fuqi të tyre, do të duhet të respektohen, detyrimisht, të gjitha afatet dhe procedurat e parashikuara nga neni 117 i Kushtetutës. Nga ana tjetër, përmbajtja e pjesës së dytë të dispozitës kushtetuese në shqyrtim, ku thuhet: “Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve”, tregon qartë se ato hyjnë në fuqi menjëherë. Me një interpretim “a contrario” të kësaj fjalie, kuptohet se aktet normative me fuqinë e ligjit duhet ta disponojnë fuqinë juridike që nga krijimi i tyre, me qëllim që të ekzistojë mundësia për ta humbur atë, po nga fillimi, kur nuk miratohen prej Kuvendit, si dhe kur kalon afati 45-ditor pa u marrë në shqyrtim prej tij. Për të gjitha arsyet e mësipërme, Gjykata Kushtetuese çmon gjithashtu, se njoftimi publik i aktit normativ me fuqinë e ligjit është detyrim kushtetues për organin që e nxjerr atë. Megjithatë, bërja publike e këtyre akteve nuk ka si domosdoshmëri botimin në “Fletoren zyrtare”. Këshilli i Ministrave, për këtë qëllim, mund të përdorë, në funksion të kohës që ka në dispozicion, krahas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe komunikimin zyrtar me mjete të tjera të përshtatshme, njoftimin me anë të mediave, apo mjete të tjera si këto. Pavarësisht nga forma e përzgjedhur për komunikimin publik, njoftimi duhet të mbërrijë detyrimisht në adresë të subjekteve që lidhen me të drejtat e detyrimet që krijon akti normativ me fuqinë e ligjit, me qëllim që ata të mos cenohen”.

2.6 Nga sa më sipër rezulton se akti normativ nr.13/2020, ka hyrë në fuqi më datë 2 prill 2020 dhe akti normativ nr.22/2020, rezulton të ketë hyrë në fuqi më datë 27 maj 2020. Mbi këtë bazë Komisioni do të vlerësojë nëse jemi përpara shkeljeve nga ana e përmbaruesit {...} {...}.

2.7 Për sa i përket shkresës nr. {...} prot., datë {...}, duke analizuar përmbajtjen e saj, rezulton se kjo shkresë i drejtohet organeve tatimore dhe është një përgjigje e shkresës nr. {...} prot., datë {...} të {...}. Në thelb të kësaj përgjigjeje, rezulton se përmbaruesi {...} {...}, shpreh mosdakordësinë e tij në lidhje me zgjidhjen e ofruar nga pala debitorë (organet tatimore) në këtë rast. Pra, nuk rezulton që nga ana e përmbaruesit të jetë realizuar ndonjë veprim konkret përmbarimor.

2.8 Për sa i përket shkresës nr. {...} prot., datë {...} rezulton se ajo është nxjerrë me {...}, është dërguar me postë dhe rezulton të ketë arritur tek debitori më datë {...}. Duke qenë se që nga data e marrjes dijeni të debitorit, ky veprim përmbarimor fillon dhe realizon efektet e tij, atëherë, rezulton qartazi që veprimi të jetë kryer pas shfuqizimit të ndalimeve për kryerjen e veprimeve përmbarimore.

2.9 Në lidhje me veprimin tjetër përmbartimor, treguar në shkresën nr. {...} prot., datë {...}, rezulton qartazi se ai është kryer pas datës {...} dhe për rrjedhojë jashtë periudhës së ndalimit.

Për këtë arsye Komisioni vlerëson se pretendimet se, këto veprime janë kryer në shkelje të kuadrit ligjor në fuqi, nuk qëndrojnë.

3. Mbi pretendimin për mosvulosjen e dokumenteve përmbartimore.

3.1 Ministri i Drejtësisë pretendon se, nga ana e përmbartuesit privat {...} {...}, në kryerjen e veprimeve përmbartimore të caktuara, si edhe në krijimin e shkresave për këtë qëllim, nuk ka përdorur vulën e tij si përmbartues gjyqësor privat. Shkresat për të cilat pretendohet se nuk është vendosur vulë janë:

- 1) Shkresa nr. {...} prot., datë {...};
- 2) Shkresa nr. {...} prot., datë {...}.

3.2 Vula e përmbartuesit gjyqësor privat është një element shumë i rëndësishëm i parashikuar nga neni 21, pika 4, germa “e”, neni 43, pikat 2, 3 dhe 4, neni 44 si edhe neni 49, pika 5 të ligjit nr. 26/2019. Rëndësi në këtë rast merr formulimi i nenit 44 i cili parashikon se:

“1. Përmbartuesi gjyqësor privat ka vulën e vet personale dhe plumbin e sekuestrimit përmbartimor, që përmbajnë emrin e tij, të cilët vendosen në çdo dokument që ai krijon gjatë veprimtarisë së tij profesionale dhe/ose vendosen në sendet e luajtshme apo të paluajtshme, të cilat i sekuestron, apo për të cilat kryen një veprim përmbartimor.

2. Përmbartuesi gjyqësor privat pajiset me dokument identifikimi si përmbartues gjyqësor privat të cilin e paraqet në çdo rast të ushtrimit të detyrës.

3. Dokumenti përdoret vetëm gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj.

4. Dokumenti i identifikimit duhet të përmbajë:

- a) emrin, mbiemrin e përmbartuesit gjyqësor privat;*
- b) stemën e Republikës së Shqipërisë dhe logon e Dhomës;*
- c) selinë ku do të ushtrojë veprimtarinë përmbartuesi gjyqësor privat;*
- ç) numrin e licencës së ushtrimit të veprimtarisë përmbartimore; dhe*
- d) Numrin e Identifikimit të Subjektit (NUIS).*

5. Forma dhe përmbajtja e vulës, forma e dokumentit të identifikimit dhe e plumbit të sekuestrimit përmbartimor përcaktohen me urdhër të ministrit, me propozim të Dhomës”.

3.3 Sipas parashikimit ligjor të mësipërm, vula është një element i rëndësishëm, që vendoset në çdo dokument që krijon përmbartuesi gjyqësor privat. Megjithëse është e vërtetë se disa dokumente të përmbartuesit, që ekzistojnë në dosjen e përcjellë nga ministri i Drejtësisë për Komisionin, nuk kanë vula, rezultojnë se ato janë kopjet e përmbartuesit gjyqësor, që ndodhen në kopjen e dosjes së tij. Nga dokumentacioni i dërguar prej ministrit të Drejtësisë nuk u provua që kopjet e shkresave që u janë dërguar debitorëve përkatës janë apo jo të vulosura.

3.4 Komisioni thekson se neni 82, pika 1 e Kodit të Procedurave Administrative, parashikon se:

“Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Në rastin e kësaj procedure, e cila fillon gjithmonë me kërkesë të ministrit të Drejtësisë, ishte barra e saj e provës që të tregonte dhe provonte që shkresat që i janë dërguar debitorëve ishin të pavulosura.

Mbi bazën e arsyetimit të mësipërm, Komisioni çmon se pretendimi i mësipërm nuk u provua.

4. Mbi pretendimin për mosqartësinë në hartimin e shkresave.

4.1 Në pretendimet e paraqitura nga ministri i Drejtësisë, rezulton se nga ana e përmbartuesit nuk është mbajtur një qëndrim i saktë në lidhje me një veprim përmbartimor të caktuar. Lidhur me këtë, pretendohet se:

- a) Nuk mund t'i kërkojë institucioneve që të kryejnë hetime administrative se përse është zvarritur ekzekutimi në funksion të procesit të ekzekutimit.
- b) Konsiderimi si i anuluar i urdhrin nr. {...} prot., datë {...} për vendosje sekuestro.
- c) Heqja e sekuestros jashtë kriterëve të nenit 617 të Kodit të Procedurës Civile.

4.2 Në lidhje me pretendimin e parë, Komisioni çmon se nga ana e përmbartuesit {...} {...} është kërkuar zhvillimi i një hetimi administrativ dhe pikërisht ky fakt konsiderohet shkelje për shkak se, sipas ministrit, përmbartuesi nuk ka të drejtë të kërkojë diçka të tillë.

4.3 Komisioni, vlerëson se ky qëndrim i ministrit të Drejtësisë nuk është i mbështetur në ligj. Kjo për arsye se, kërkesa për hetim administrativ që përmbartuesi i ka bërë institucionit debitor, lidhet me procedurën e ekzekutimit e cila ishte zvarritur dhe shtyrë për shumë kohë. Pra, përmbartuesi nuk ka kërkuar fillimin e hetimit administrativ në lidhje me tematika të ndryshme, por për një çështje në interesin e tij dhe të palës kreditore për të cilën ishte vënë në lëvizje.

4.4 Gjithashtu Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 41, parashikon se:

“1. Procedura administrative fillon kryesisht ose me kërkesë.

2. Fillimi i procedurës kryesisht është në diskrecionin e organit publik. Organi publik është i detyruar të fillojë procedurën administrative kryesisht kur:

a) ligji ose akti nënligjor parashikon fillimin e procedurës;

b) situata faktike është e tillë që organi publik duhet të fillojë procedurën administrative për mbrojtjen e interesit publik.

3. Procedura administrative konsiderohet e filluar:

a) me kryerjen e çdo veprimi procedural nga organi publik në rastin e procedurës së filluar kryesisht; ose

b) me paraqitjen e kërkesës përpara organit publik, në rastin e procedurës së filluar me kërkesë”.

Nga sa më sipër qartazi, nuk rezulton ndonjë pengesë për përmbartuesin që të kërkojë kryerjen e një hetimi administrativ, për më tepër kur lidhet me shkakun e zvarritjes së një procedure ekzekutimi.

4.5 Komisioni thekson se, zvarritja e një procedure ekzekutimi sjell dëm për të dyja palët, si atë kreditore dhe atë debitore, për më tepër kur kjo e fundit është organ publik. Pala kreditore dëmtohet nga mosrealizimi në kohë i së drejtës së saj. Ndërsa, pala debitore e rëndon situatën e saj nga moskezkuetimi në kohë, pasi e ekspozon veten ndaj detyrimeve të tjera në formën e interesave,

kamatëvonesave, ose edhe të shtimit të detyrimit si në rastin konkret, e cila përmban detyrimin që të paguajë pagën deri në momentin e ekzekutimit të vendimit.

Për sa më sipër, Komisioni nuk gjen shkelje nga ana e përmbauesit gjyqësor {...} {...}, në këtë rast.

4.6 Ndërsa në lidhje me pretendimin për saktësinë e terminologjisë së përdorur, ministri i referohet Kodit të Etikës Profesionale të Përmbauesit Gjyqësor Privat, miratuar nga ministri i Drejtësisë më urdhrin nr.136, datë 27.4.2020.

Komisioni çmon se në këtë rast nuk kemi ndonjë intensitet apo pasojë reale të provuar, për më tepër që bëhet fjalë për një vlerësim të natyrës tepër subjektive. Për rrjedhojë, vlerësohet se, nuk ka vend për penalizimin e përmbauesit.

5. Mbi pretendimin për kryerjen e veprimeve përmbaimore pa kërkesën e debitorit (shkresat nr. {...} prot., datë {...}; nr. {...} prot., datë {...}; nr. {...}prot., datë {...}).

5.1 Në lidhje me këtë pretendim, Komisioni çmon se kreditorja nuk ka qenë e qartë në kërkimet e saj dhe se ato nuk kanë qenë në përputhje me ligjin, ndërsa kërkonte prej përmbauesit {...} {...}, se duhej të vijonte me procedurat e ekzekutimit, siç parashikohej edhe në marrëdhënien e krijuar fillimisht ndërmjet tyre.

5.2 Neni 7, pika 2 e Kodit të Etikës, zbatohet në ato raste kur dhe kërkesa e kreditorit, konsiderohet e ligjshme. Për sa kohë, arsyeja e vetme ligjore për kontraktimin e përmbauesit {...} {...}, ka qenë pikërisht ekzekutimi i një vendimi gjyqësor të formës së prerë, atëherë gjendemi brenda kuadrit ligjor të zbatueshëm në fuqi.

Për këtë arsye Komisioni nuk e konsideron si shkelje edhe këtë pretendim kundër përmbauesit {...} {...}.

6. Mbi pretendimin për mosnjoftimin e caktimit të ekspertit.

6.1 Ministri i Drejtësisë pretendon se, nga ana e përmbauesit {...} {...} nuk është njoftuar pala debitore, lidhur me kryerjen e hapit procedural për caktimin e ekspertit.

6.2 Kodi i Procedurës Civile i njeh përmbauesit mundësinë e caktimit të një eksperti. Konkretisht, kjo mundësi parashikohet nga nenet 544, 552 dhe 564 të Kodit të Procedurës Civile. Nga mënyra e formulimit të këtyre neneve dhe më konkretisht e nenit 564, Komisioni vlerëson se në këtë rast caktimi nga përmbauesi i një eksperti ka natyrë të ndryshme nga caktimi i një eksperti nga ana e gjykatës. Neni 564 i Kodit të Procedurës Civile, parashikon se:

“Nëse kreditori dhe debitori, brenda një jave, nuk arrijnë një marrëveshje për vlerën e sendit, mbi të cilin është vendosur sekuestro, sendi i paluajtshëm, mbi të cilin është vendosur sekuestro, vlerësohet me vendim nga përmbauesi gjyqësor, brenda 15 ditëve, në asistencën teknike të një eksperti të licencuar të fushës. Në përcaktimin e vlerës së sendit, përmbauesi gjyqësor bazohet në metodologjinë e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Përmbauesi gjyqësor, brenda 10 ditëve nga data e caktimit të vlerës, njofton kreditorin dhe debitorin për çmimin e caktuar.

Kundër vendimit të përmbauesit gjyqësor palët mund të bëjnë ankim, sipas rregullave të parashikuara në nenin 610 të këtij Kodi”.

6.3 Formulimi i mësipërm ligjor qartazi dallon nga formulimi që ka neni 224/a i Kodit të Procedurës Civile, sipas së cilit:

“Kur për konstatimin ose sqarimin e fakteve, që kanë lidhje me mosmarrëveshjen në gjykim kërkohen njohuri të posaçme në fushat e shkencës, teknikës ose të artit, gjykata mund të thërrasë një ose më shumë ekspertë”.

6.4 Nga sa më sipër, rezulton se veprimet përmbaimore kryhen nga përmbauesi gjyqësor, i cili mund të kërkojë vlerësimin teknik të një eksperti, ndryshe nga veprimet gjyqësore, në të cilat eksperti ka një rol të veçantë në konstatimin ose sqarimin e fakteve objekt gjykimi.

6.5 Gjithashtu, Komisioni merr në konsideratë që afati ankimor për kundërshtimin e vlerësimit të bërë nga përmbauesi, me asistencën e një eksperti, kundërshtohet brenda 5 ditëve nga marrja dijani për këtë veprim përmbaimore. Pra, fakti i mosnjoftimit të menjëhershëm nuk e shuan të drejtën e palëve në një procedurë ekzekutimi, për të kundërshtuar veprimet përmbaimore në momentin që ato marrin dijani.

6.6 Komisioni çmon gjithashtu se në këtë rast, eksperti që ka asistuar përmbauesin ka pasur një rol shumë të kufizuar. Asistenca e tij në këtë rast kishte të bënte me identifikimin e llojit të mjeteve mbi të cilat do të bëhej ekzekutimi dhe jo me procedura vlerësimi etj. Në këtë pikë, Komisioni konstaton që, edhe pse pala debitore ka marrë dijani për ekspertin dhe mënyrën e caktimit të makinerive, nuk rezulton që të këtë ushtruar asnjë ankim mbi këto veprime përmbaimore.

Për sa më sipër Komisioni vlerëson dhe e konsideron këtë pretendim të pabazuar.

7. Mbi pretendimin për përdorimin e gjuhës jo etike (shkresën nr. {...} prot., datë {...} dhe nr. {...} prot., datë {...}).

7.1 Në lidhje me këtë pretendim rezulton se përmbauesi gjyqësor privat i është drejtuar kreditores duke përdorur shprehitë e mëposhtme:

“{...}”.

“{...}”.

7.2 Po kështu përmbauesi i është drejtuar dhe palës debitore, {...}, ku shprehet se: “{...}”.

7.3 Në rastin konkret, Komisioni çmon se gjuha e përdorur nga përmbauesi nuk është brenda kornizës së sistemit deontologjik profesional. Megjithatë, nisur nga fakti se të dyja komunikimet ndodhen brenda të njëjtës procedurë përmbaimore, dhe nuk kanë krijuar intensitet, përsëritje, nuk provohet të kenë ndodhur në raste të tjera dhe nuk kanë derivuar me asnjë pasojë reale, Komisioni çmon se nuk ka vend për penalizimin e përmbauesit gjyqësor edhe në këtë rast.

8. Mbi pretendimin për mosnjoftimin e veprimeve procedurale të gjitha palëve në proces (neni 610 i Kodit të Procedurës Civile dhe neni 37, germa “ç”) e ligjit nr. 26/2019).

8.1 Në raportin e ministrit të Drejtësisë, është paraqitur pretendimi për mosnjoftimin e palëve në procedurën përbarimore. Më konkretisht, pretendimet janë se nuk janë njoftuar:

- kreditorja {....} {....} për shkresat: nr. {....} prot., datë {....} dhe nr. {....} prot., datë {....};
- debitori {....} për shkresat: urdhri nr. {....} prot., datë {....}, vendim nr. {....} prot., datë {....}, shkresën nr. {....} prot., datë {....}, si dhe vendimin nr. {....}, datë {....};
- debitori {....} ({....}) për shkresat: vendimi nr. {....} prot., datë {....}, shkresa nr. {....} prot., datë {....}, si dhe nr. {....}, datë {....}.

8.2 Në lidhje me sa më sipër, ministri i Drejtësisë pretendon se, kjo mënyrë veprimi cenon të drejtat e palëve për të kundërshtuar veprimet përbarimore, sipas nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile. Ligji nr. 26/2019, në nenin 37, germa “ç” të tij parashikon se:

“Përmbaruesi gjyqësor privat ka këto detyra:

...ç) të informojë për çdo veprim procedural palët në proces ekzekutimi, si dhe të japë sqarimet e nevojshme për veprimet e kryera”.

8.3 Nga ana tjetër, Kodi i Procedurës Civile në nenin 610 të saj, parashikon se:

“Kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, të kryera në kundërshtim me procedurat e parashikuara nga ky Kod dhe kundër refuzimit të përmbaruesit gjyqësor për të kryer një veprim që ia ngarkon ligji, palët mund të bëjnë ankim në gjykatën që ekzekuton vendimin, brenda 5 ditëve nga dita e kryerjes së veprimit ose refuzimit, kur palët kanë qenë të pranishme në kryerjen e veprimit ose kanë qenë thirrur dhe në raste të tjera, nga dita që u është njoftuar ose kanë marrë dijeni për veprimin ose refuzimin”.

8.4 Referuar parashikimeve të mësipërme, rezulton se e drejta e palëve për të kundërshtuar në një procedurë përbarimore nuk shuhet me kryerjen e veprimeve nga përmbaruesi gjyqësor, por përkundrazi, e drejta e tyre lind me marrjen dijeni për veprimin përbarimor. Pikërisht nga ky moment fillon të ecë afati. Në rastin konkret, rezulton se asnjë prej palëve nuk u ka kaluar ky afat ankimor, si edhe nuk kanë paraqitur kundërshtime të veprimeve përbarimore në gjykatë. Për sa më sipër, Komisioni çmon se në mungesë të një pasojë konkrete, nuk ka vend për penalizimin e përmbaruesit {....} {....}.

9. Mbi pretendimin për mosdhënie informacioni Ministrisë së Drejtësisë.

9.1 Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. {....} prot., datë {....}, ka kërkuar informacion specifik në lidhje me rastin e kreditorës {....} {....}. Përmbaruesi {....} {....} ka kthyer një përgjigje me shkresën e datës {....}, por nga përmbajtja e saj nuk rezulton që të ketë përgjigje konkrete në lidhje me informacionin e kërkuar.

9.2 Ligji nr. 26/2019, në nenin 58, pika 4, gjerat “b”, dhe “c” parashikon se:

“4. Ministria ka të drejtë:

...b) të kërkojë nga përmbaruesi gjyqësor privat të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me veprimtarinë e tij;

c) të kërkojë raporte për masat e marra nga përmbaruesi gjyqësor privat për ekzekutimin e çështjeve përbarimore”.

9.3 Referuar parashikimit të mësipërm, Komisioni vlerëson se në këtë rast ministri mund të kërkojë të gjithë informacionin e nevojshëm tek përmbauesit gjyqësorë privatë, pasi kjo përfshihet brenda nocionit të së drejtës së kontrollit që ministri i Drejtësisë ka. Në rastin konkret, përmbauesi {....} {....} nuk ka dhënë informacionin e kërkuar. Megjithatë, nisur nga fakti se më pas është tërhequr e gjitha dosja përmbaimore nga ana e strukturave përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë, Komisioni çmon se nuk ka ardhur asnjë pasojë negative në këtë rast, sa kohë materiali përmbaimor është administruar i plotë dhe për rrjedhojë nuk ka vend për penalizimin e përmbauesit {....} {....}.

10. Mbi pretendimin për anulimin e veprimit përmbaimor nga Gjykata e Shkallës së Parë Durrës me vendimin nr. {....}, datë {....}.

10.1 Rezulton se përmbauesi {....} {....}, me shkresën nr. {....} prot., datë {....} ka proceduar me vendim për pushim të urdhrit të ekzekutimit si të ekzekutuar tërësisht ({....}). Ky vendim është anuluar me vendimin nr. {....}, datë {....} të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

10.2 Në lidhje me këtë pretendim, vlerësohet se jo domosdoshmërisht çdo veprim që anulohet nga gjykata përbën shkelje për përmbauesin gjyqësor. Në çdo rast, përmbauesi gjyqësor është edhe interpretues i ligjit dhe për rrjedhojë nëse interpretimi që ai ka bërë, përbën apo jo shkelje, do të vlerësohet rast pas rast në varësi të rrethanave të çështjes.

10.3 Në rastin konkret, megjithëse veprimi i përmbauesit {....} {....} është anuluar nga Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, rezulton se mbi të njëjtën çështje, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë me vendimin nr. {....} ({....}) akti, datë {....} ka urdhëruar pezullim të veprimeve përmbaimore të nisura, pikërisht pas vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës. Në këtë rast, kur vetë gjykatat kanë patur qëndrime të ndryshme për të njëjtën situatë, Komisioni çmon se nuk mund të penalizohet përmbauesi.

11. Mbi pretendimin për mosfaturimin dhe arkëtimin e parapagimit nga kreditori shoqëria Albanian Stevedoring Company për titullin ekzekutiv, vendim nr. {....}, datë {....} i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ndryshuar me vendimin nr. {....}, datë {....} të Gjykatës së Apelit Durrës.

11.1 Në lidhje me këtë pretendim, rezulton se me faturën nr. {....}, datë {....} përmbauesi {....} {....} ka proceduar me lëshimin e faturës tatimore në emër të blerësit, palë kreditore në proces, në vlerën 600 098 lekë (720 117.6 lekë llogaritur me TVSH). Ministri i Drejtësisë pretendon se kjo nuk është tarifa e plotë, referuar në këtë rast udhëzimit të përbashkët nr. 385/7, datë 28.6.2017 për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbaimor gjyqësor privat kreu III, pika 2, si dhe pika 3, germa “f”).

11.2 Komisioni vlerëson se megjithëse ngrihet ky pretendim, në raportin e grupit të punës, por edhe në aktet e tjera të prodhuara nga Ministria e Drejtësisë, nuk rezulton që të jetë nxjerrë një vlerë tjetër. Pra, nuk del sa duhet që të ketë qenë kjo vlerë sipas pretendimit të Ministrisë së Financave. Komisioni, në këtë rast i referohet nenit 82 të Kodit të Procedurave Administrative sipas të cilës:

- “1. Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, **barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë**, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.
2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.
3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, **palët mund t'i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme.**
4. **Palët mund t'i kërkojnë organit publik që të marrë masat e nevojshme për të siguruar përdorimin e provave të zotëruara prej tij gjatë procedurës administrative”.**

11.3 Ligji nr. 26/2019, në nenin 71, pika 1 të tij, parashikon se:

“Në përfundim të hetimit, nëse ka dyshime të arsyeshme që përmbaruesi gjyqësor privat, ka kryer shkelje disiplinore, ministri fillon procedimin disiplinor, **duke paraqitur në Komisionin Disiplinor raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore”.**

11.4 Gjithashtu, ligji nr. 26/2019, në nenin 70, pika 3, geramat “d” dhe “dh”, parashikon se:

“[...] 3. Me përfundimin e hetimit, struktura përgjegjëse në ministri harton raportin e hetimit, i cili përmban të paktën:

...d) parashtrimin e fakteve të pranuar dhe të papranuara, ashtu si edhe të provave, si dhe vlerësimin e vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre;

dh) analizën ligjore të fakteve të pranuar që mbështesin përfundimin se shkelja disiplinore e pretenduar është kryer ose se hetimi duhet mbyllur”.

11.5 Referuar nga sa më sipër, nuk rezulton që materiali dërguar nga ministri i Drejtësisë të ketë nxjerrë një vlerë të ndryshme, megjithëse kishte barrën e provës në këtë procedim. Për rrjedhojë, duke munguar vërtetësia apo pavërtetësia e vlerësimit që ka bërë përmbaruesi {...} {...}, Komisioni çmon se ky pretendim mbetet i paprovuar.

VI. Konkluzionet e procesit disiplinor.

Pas kësaj analize ligjore, në kuadër të kryerjes së plotë të hetimit administrativ ndaj veprimtarisë së përmbaruesit – objekt i këtij procesit disiplinor, në referim të kërkesës së ministrit të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj përmbaruesit gjyqësor privat {...} {...}, Komisioni Disiplinor arrin në konkluzionin dhe vendimmarrjen vijuese.

Nga analiza e plotë e dokumenteve, fakteve dhe provave të administruara në këtë proces administrativ, në mbështetje të nenit 80, pika 2, germa “a)” të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, Komisioni Disiplinor,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk përbëjnë shkelje disiplinore.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i njoftohet me shkrim ministrit të Drejtësisë nga ana e Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë.
3. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet e drejta e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ky vendim, me marrjen formë të prerë të tij, botohet nga ana e Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë dhe Ministria e Drejtësisë, në faqet e respektive zyrtare, duke marrë masat përkatëse për garantimin e mbrojtjes së konfidencialitetit sipas ligjit.

Anëtar

Erind MËRKURI

Anëtar

Tedi MALAVECI

Kryetar

Vangjel KOSTA